

STATUT I SHOQERISE ME PERGJEGJESI TE KUFIZUAR  
"PORTONOVA"

Ne këtë statut:

- "Ligji" është Ligji Nr. 9901, dt. 14.04.2008 "Për Tregtaret dhe Shoqëritë tregtare";
- "Statuti" është Statuti i shoqërisë;

**KREU I**  
**THEMELIMI, EMRI, OBJEKTI, KOHEZGJATJA, SELIA**

Neni 1

**Data e Themelimit, Emri dhe Themeluesit**

Sot, me date 9 /09/2019 ne, themeluesit, kemi krijuar një shoqëri me përgjegjësi te kufizuar me emrin "Portonova" Sh.P.K.

Themeluesit e shoqërisë janë:

1. **Agron Hyseni** i biri i Laver i datëlindjes 02.06.1969 lindur dhe banues ne Vlore identifikuar nëpërmjet dokumentit te identifikimit Kartë Identiteti me Nr. G90602056L
2. **Artur Shehu** i biri i Ramis lindur ne Vlorë i datëlindjes 29.07.1966 dhe banues ne SHBA mbajtes i letërnjoftimit me Nr. personal G607290630, perfaqesuar me prokure te posacme Nr. 203 Rep., Nr. 89 Kol., date 12.08.2016 nga z. **Lenard Bishaj** i biri i Ferik lindur me 24.03.1969 ne Vlorë, banues ne Vlorë mbajtes i letërnjoftimit me Nr. personal G90324083R.

Neni 2

**Objekti**

Objekti paresor i veprimtarise se shoqerise eshte:

Projektimi, ndertimi, venia ne shfrytezim e komplekseve turistik, strukturave hotelerie dhe e objekteve turistike sezonale.

Shitja e objekteve me destinacion rezidencial veror dhe/ose administrimi i tyre, si dhe ofrimi i sherbimeve te hoteleri-turizmit/agroturizmit si dhe cdo veprimtari tjetër plotesuese, qe lidhet direkt ose indirekt me vepimtarine e siperpermendur.

Shoqeria mund te bashkepunoje dhe/ose bleje/perfitoje direkt ose indirekt pjesemarrje, ne shoqeri, ndermarrje, agjenci apo sipermarrje te tjera, te cilat kane fushe veprimtarie te njejte ose te ngjashme.

Gjithashtu, shoqeria mund te kryeje cdo veprim apo operacion tjetër qe ka te beje me pronat e paluajtshme, te luajtshme, cdo veprim apo operacion tjetër komercial, industrial e financiar, te dobishem apo plotesues ndaj permbushjes se objektit si dhe ne çdo fushe tjetër te mundshme qe paraqitet ne te ardhmen.

Neni 3  
**Kohëzgjatja**

Kohëzgjatja e shoqërisë do të jete pa afat vetëm në rast se do të verifikohet ndonjë nga rastet e parashikuara në nenin 18 të këtij statuti ose ndonjë event tjetër i cili mund të shkaktoj prishjen e shoqërisë sipas legjislacionit në fuqi.

Neni 4  
**Selia**

Selia e shoqërisë ndodhet në Vlorë në adresën: Prane kompleksit kristal Uji i ftohte Vlorë. Vendndodhja e shoqërisë mund të ndryshohet me kërkesë të administratorit komunikuar me pare edhe ortakeve të tjerë.

Shoqëria mund të përcaktojë edhe dege të tjera brenda ose jashtë Shqipërisë në përputhje me këtë statut dhe ligjin e aplikueshëm të vendit përkatës.

Adresa e faqes së internetit të shoqërisë është \_\_\_\_\_

Adresa e shoqërisë për qëllime komunikimi elektronik është: Enkes.h@hotmail.it

**KREU II**  
**KAPITALI**

Neni 5  
**Kapitali themeltar**

Kapitali themeltar fillestar i shoqërisë është 100.000 Leke.

Pjesëmarrja e themeluesve në kapitalin e shoqërisë është në përputhje me kontributet e tyre të mëposhtme:

1. Ortaku themelues **Agron Hyseni** zotërues i 1 (një) kuote me vlerë të përgjithshme 50.000 lek e cila përbën 50 % të kapitalit themeltar të shoqërisë.
2. Ortaku themelues **Artur Shehu** zotërues i 1 (një) kuote me vlerë të përgjithshme 50.000 leke e cila përbën 50 % të kapitalit themeltar të shoqërisë.

Kontributi i ortakeve mund të jete në para dhe në natyrë.

Neni 6  
**Zmadhimi dhe zvogëlimi i kapitalit**

Kapitali i shoqërisë mund të zmadhohet nëpërmjet nënshkrimeve të pjesëve të kapitalit themeltar për kontributet në para dhe me anë të kontributeve në natyrë, nëpërmjet emërimit nga gjykata kompetente e një eksperti të autorizuar për këto kontribute sipas kërkesës së administratorit.

Zvogëlimi i kapitalit lejohet nga asambleja e ortakeve, e cila merr vendim në të njëjtat kushte që kërkohen për ndryshimin e statudit.

Në të gjitha rastet zvogëlimi i prek ortaket në të njëjtën masë ndaj pjesëve

te kapitalit qe përfaqësojnë përveç rastit qe asambleja e përgjithshme me shumice votash vendos ndryshe.

Neni 7

### **Transferimi i kapitalit**

Kuotat e kapitalit te shoqërisë dhe te drejtat qe rrjedhin prej tyre mund te fitohen apo kalohen nëpërmjet:

- a) kontributit ne kapitalin e shoqërisë;
- b) shitblerjes;
- c) trashëgimisë;
- d) dhurimit;
- e) çdo mënyre tjetër te parashikuar me ligj.

Pjesët e kapitalit themeltar janë lirisht te transferueshme ndërmjet ortakeve, për sa nuk parashikohet ndryshe ne statut. Çdo lloj transferimi kundrejt te treteve (jo ortake) duke përfshirë edhe dhurimin do te mund te kryhet vetëm nëpërmjet autorizimit te shprehur ne mënyrë paraprake nga asambleja e përgjithshme me shumice votash te pjesëmarrësve.

Çdo partner gëzon te drejtën e parablerjes me te kundrejt te njëjtit çmim i cili duhet ti jepet një afat minimal prej 3 muajsh nga momenti i komunikimit te projektit te transferimit te kuotave.

Pjesët e kapitalit themeltar janë lirisht te transferueshme vetëm me rruge trashëgimie.

## **KREU III**

### **ORGANET VENDIMMARRESE DHE DREJTUESE**

Neni 8

#### **Organi Vendim-marres**

Asambleja e Ortakeve është organi i vetëm vendimmarrës i shoqërisë.

Asambleja e Ortakeve është organi i vetëm vendimmarrës i shoqërisë qe miraton çdo ndryshim te statutit sipas modaliteteve te përcaktuara ne ligj. Asambleja e përgjithshme e ortakeve është përgjegjëse për marrjen e vendimeve për shoqërinë për çështjet e mëposhtme:

- a. përcaktimin e politikave tregtare te shoqërisë;
- b. ndryshimet e statutit;
- c. emërimin e shkarkimin e administratoreve;
- d. emërimin e shkarkimin i likuiduesve dhe te eksperteve kontabël te autorizuar;
- e. përcaktimin e shpërblimeve për personat e përmendur ne shkronjat "c" dhe "d" te kësaj pike;
- f. mbikëqyrjen e zbatimit te politikave tregtare nga administratoret, përfshirë përgatitjen e pasqyrave financiare vjetore dhe te raporteve te ecurisë se veprimtarisë;
- g. miratimin e pasqyrave financiare vjetore dhe te raporteve te ecurisë se veprimtarisë;

- h. shpërndarjen e dividendit vjetor
- i. zmadhimin dhe zvogëlimin e kapitalit;
- j. pjesëtimin e kuotave dhe anulimin e tyre;
- k. përfaqësimin e shoqërisë në gjykate dhe në procedimet e tjera ndaj administratoreve;
- l. riorganizimin dhe prishjen e shoqërisë;
- m. miratimin e rregullave procedurale të mbledhjeve të asamblesë;
- n. çështje të tjera të parashikuara nga ligji apo statuti.

Ortaku mund të përfaqësohet në asamblenë e përgjithshme, në bazë të një autorizimi me shkrim nga një ortak tjetër apo nga një person i tretë.

Administratori i shoqërisë nuk mund të veprojë si përfaqësues i ortakeve në asamblenë e përgjithshme.

Autorizimi mund të jepet vetëm për një mbledhje të asamblesë së përgjithshme, e cila përfshin edhe mbledhjet vijuese me të njëjtin rend dite.

#### Neni 9

##### **Mënyra e thirrjes së mbledhjes së Asamblesë së Përgjithshme**

Asambleja e përgjithshme thirret nëpërmjet një njoftimi me shkrese ose, nëse parashikohet nga statuti, me njoftim nëpërmjet postes elektronike. Në çdo rast duhet të jetë konfirmuar marrja e dijeni. Njoftimi me shkrese apo me mesazh elektronik duhet të përmbajë vendin, datën, orën e mbledhjes dhe rendin e ditës e t'u dërgohet të gjithë ortakeve, jo më vonë se 15 ditë përpara datës së parashikuar për mbledhjen e asamblesë.

Kur asambleja e përgjithshme nuk është thirrur sipas pikës 1 të këtij neni, ajo mund të marrë vendime të vlefshme vetëm nëse të gjithë ortakët janë dakord, për të marrë vendime, pavarësisht parregullsisë.

#### Neni 10

##### **Kuorumi**

Në rastin e marrjes së vendimeve, që kërkojnë një shumicë të zakonshme, asambleja e përgjithshme mund të marrë vendime të vlefshme vetëm nëse marrin pjesë ortakët me të drejtë vote, që zotërojnë më shumë se 30 për qind të kuotave.

Në rastin kur asambleja e përgjithshme duhet të vendosë për çështje, të cilat kërkojnë shumicë të kualifikuar sipas nenit 87 të ligjit " Për Tregtarët dhe Shoqëritë Tregtare ", ajo mund të marrë vendime të vlefshme vetëm, nëse ortakët që zotërojnë më shumë se gjysmën e numrit total të votave, janë të pranishëm personalisht, votojnë me shkrese, apo mjete elektronike, sipas parashikimeve të pikës 3 të nenit 88 të këtij ligji.

Nëse asambleja e përgjithshme nuk mund të mbledhet për shkak të mungesës së kuorumit të përmendur më lart, asambleja mbledhet përsëri jo më vonë se 30 ditë, me të njëjtin rend dite.



Neni 11  
**Marrja e vendimeve**

Asambleja e përgjithshme vendos me tri te katërtat e votave te zotëruesve te kapitalit, te ortakeve pjesëmarrës, për ndryshimin e statutit, zmadhimin ose zvogëlimin e kapitalit te regjistruar, shpërndarjen e fitimeve, riorganizimin dhe prishjen e shoqërisë.

Asambleja e përgjithshme vendos me shumicën e votave te ortakeve pjesëmarrës, për çështje to tjera si: përcaktimi i politikave tregtare te shoqërisë; emërimin dhe shkarkimin e administratoreve; emërimin e shkarkimin i likuiduesve dhe te eksperteve kontabël te autorizuar; përcaktimin e shpërblimeve; mbikëqyrjen e zbatimit te politikave tregtare nga administratoret, përfshirë përgatitjen e pasqyrave financiare vjetore dhe te raporteve te ecurisë se veprimtarisë; përfaqësimin e shoqërisë ne gjykate dhe ne procedimet e tjera ndaj administratoreve; miratimin e rregullave procedurale te mbledhjeve te asamblesë;

Çdo ndryshim statuti duhet te depozitohet pranë QKR për te pasqyruar ndryshimet ne skedën e shoqërisë.

Neni 12  
**Përjashtimi nga e drejta e votës**

1. Ortaku nuk mund ushtroje te drejtën e votës nëse asambleja e përgjithshme merr vendim për:

- a. vlerësimin e veprimtarisë se tij;
- b. shuarjen e ndonjë detyrimi ne ngarkim te tij;
- c. ngritjen e një padie ndaj tij nga shoqëria;
- d. dhënien ose jo te përfitimeve te reja.

2. Kur ortaku përfaqësohet nga një përfaqësues i autorizuar, i autorizuari vlerësohet te jete ne te njëjtin konflikt interesi, ashtu si dhe ortaku, te cilin përfaqëson.

Neni 13  
**Administrimi**

1. Asambleja e përgjithshme emëron një ose me shume persona fizike si administrator te shoqërisë. Afati i emërimit, është 5 vjet, me te drejte ripërtëritjeje. Emërimi i administratoreve prodhon efekte pas regjistrimit ne Qendrën Kombëtare te Regjistrimit.


2. Administrator e një shoqërie tregtare mëmë, sipas përcaktimit te nenit 207 te këtij ligji, nuk mund te emërohen si administratore te një shoqërie te kontrolluar e anasjelltas. Cdo emërim i bere ne kundërshtim me këto dispozita është i pavlefshëm.

**Gaetano Çarçani** i biri i Perlat i dtl 17.03.1993 lindur dhe banues ne Vlorë posedues i dokumentit te identifikimit ID Nr. J30317110E, caktohet si Administrator i shoqërisë për një periudhe 5 vjeçare nga momenti i regjistrimit te shoqërisë.

**Gaetano Çarçani**



Gaetano Çarçani



### **Kompetencat e Administratoreve**

Administratoret kane te drejte e detyrohen te:

- a. kryejnë te gjitha veprimet e administrimit te veprimtarisë tregtare te shoqërisë, duke zbatuar politikat tregtare, te vendosura nga asambleja e përgjithshme;
- b. përfaqësojnë shoqërinë tregtare;
- c. kujdesen për mbajtjen e sakte e te rregullt te dokumenteve dhe te librave kontabël te shoqërisë;
- d. përgatisin dhe nënshkruajnë bilancin vjetor, bilancin e konsoliduar dhe raportin e ecurisë se veprimtarisë dhe, se bashku me propozimet për shpërndarjen e fitimeve, i paraqesin këto dokumente përpara asamblesë se përgjithshme për miratim;
- e. krijojnë një sistem paralajmërimi ne kohen e duhur për rrethanat, qe kërcënojnë mbarëvajtjen e veprimtarisë dhe ekzistencën e shoqërisë;
- f. kryejnë regjistrimet dhe dërgojnë te dhënat e detyrueshme te shoqërisë, siç parashikohet ne ligjin për Qendrën Kombëtare te Regjistrimit;
- g. raportojnë përpara asamblesë se përgjithshme ne lidhje me zbatimin e politikave tregtare dhe me realizimin e veprimeve to posaçme me rëndësi te veçante për veprimtarinë e shoqërisë tregtare;
- h. kryejnë detyra te tjera te përcaktuara ne Ligj dhe ne statut.

Administratoret janë te detyruar te thërrasin Asamblenë e Përgjithshme, ne rastet kur:

- sipas bilancit vjetor apo raporteve te ndërmjetme financiare, rezulton ose ekziston rreziku qe aktivet e shoqërisë nuk i mbulojnë detyrimet e kerkuesh.me brenda 3 muajve ne vazhdim.
- shoqëria propozon to shesë apo te disponoje ne mënyrë tjetër aktive, të cilat kane një vlere me te larte se 5 për qind te asetëve to shoqërisë, qe rezulton ne pasqyrat e fundit financiare te certifikuara.
- shoqëria, brenda 2 viteve te para pas regjistrimit te saj, propozon te blejë nga një ortak pasuri, qe kanë vlere me te larte se 5 për qind te asetëve te shoqërisë, qe rezulton ne pasqyrat e fundit financiare te certifikuara.

Nëse asambleja e përgjithshme emëron me shume se një administrator, ata e administrojnë bashkërisht shoqërinë.

Asambleja e përgjithshme mund te shkarkoje administratorin ne çdo kohe me shumice te zakonshme te pjesëmarrësve. Padite, qe lidhen me shpërblimin e administratorit, ne baze te marrëdhënieve kontraktore me shoqërinë, rregullohen sipas dispozitave ligjore ne fuqi.

**Përgjegjësitë e Administratorit**

Administratori është përgjegjës individualisht, ndaj shoqërisë ose ndaj te treteve, për shkelje të ligjeve, për shkelje të statutit, apo për faje të kryera gjatë administrimit të shoqërisë.

Pasojat e marrëveshjeve të pa miratuara nga asambleja që i sjellin dem shoqërisë, i ngarkohen administratorit dhe ortakut që ka bërë marrëveshjen, për të përballuar në mënyrë individuale ose solidaresh sipas rastit pasojat përkatëse.

Përveç sa është parashikuar në dispozitat e përgjithshme -18 detyrimit të besnikërisë, sipas neneve 14, 15, 17 e 18 të ligjit "Për Tregtaret dhe Shoqëritë Tregtare", administratori detyrohet:

- 1.a.** të kryejë detyrat e tij të përcaktuara në ligj dhe në statut në mirëbesim e në interesin më të mirë të shoqërisë në tërësi, duke i kushtuar vëmendje të veçantë ndikimit të veprimtarisë së shoqërisë në mjedis;
- b.** të ushtroje kompetencat që i njihen në Ligj dhe në statut vetëm për arritjen e qëllimeve të përcaktuara në këto dispozita;
- c.** të vlerësojë me përgjegjësi çështjet, për të cilat merret vendim;
- d.** të parandalojë dhe mënjanojë rastet e konfliktit, prezent apo të mundshëm, të interesave personale me ata të shoqërisë;
- e.** të ushtroje detyrat e tij me profesionalizmin dhe kujdesin e nevojshëm.

**2.** Administratori, gjatë kryerjes së detyrave të tij, përgjigjen ndaj shoqërisë për çdo veprim ose mosveprim, që lidhet në mënyrë të arsyeshme me qëllimet e shoqërisë tregtare, me përjashtim të rasteve kur, në baze të hetimit dhe vlerësimit të informacioneve përkatëse, veprimi ose mosveprimi është kryer në mirëbesim.

**3.** Nëse administratori vepron në kundërshtim me detyrat dhe shkel standardet profesionale, sipas pikave 1 e 2 të këtij neni, është i detyruar t'i dëmshpërblejë shoqërisë dëm, që rrjedhin nga kryerja e shkeljes, si dhe t'i kalojë çdo fitim personal që ata apo personat e lidhur me të kanë realizuar nga këto veprime të parregullta. Administratori ka barrën e provës për të vërtetuar kryerjen e detyrave të tyre në mënyrë të rregullt e sipas standardeve të kërkuara. Kur shkelja është kryer nga më shumë se një administrator, ata përgjigjen ndaj shoqërisë në mënyrë solidare.

**4.** Në mënyrë të veçantë, por pa u kufizuar në të, administratori është i detyruar t'i dëmshpërblejë shoqërisë dëm të shkaktuar, nëse, në kundërshtim me dispozitat e ligjit "Për Tregtaret dhe Shoqëritë Tregtare", kryen veprimet e mëposhtme:

- a.** u kthen ortakëve kontributet;
- b.** u paguan ortakëve interesa apo dividendë;
- c.** u shpërndan aktivet shoqërisë;
- d.** lejon që shoqëria të vazhdojë veprimtarinë tregtare, kur, në baze të gjendjes financiare, duhej të parashikohej që shoqëria nuk do të kishte aftësi pagese për të shlyer detyrimet;
- e.** jep kredi.

Përveç padisë për shlyerjen e dëmit që i ngarkohet personalisht administratorit, ortakët individualisht ose së bashku, kanë të drejtë të



ngrenë padi penale kundër administratorit  
Padiësit kane te drejte te ndjekin ne rruge ligjore shlyerjen e plote to  
demit qe i është shkaktuar shoqërisë, përfshirë edhe dëmshpërblimin  
financiar, nëse është e nevojshme. Asnjë vendim i asamblesë nuk mund te  
ndaloje ngritjen e kërkesë padisë kundër administratorit për gabimet e kryera  
prej tij gjate ushtrimit te detyrës.  
Çdo administrator është i detyruar te nënshkruaj një police sigurimi ne lidhje  
me përgjegjësitë civile qe lindin nga ushtrimi i aktivitetit te tij për një shume  
1.000.000 leke.

## **KREU IV VITI FINANCIAR-EKSPERTET**

Neni 16

### **Viti Financiar**

Viti financiar i Shoqërisë fillon me 1 Janar dhe përfundon me 31 Dhjetor.  
Përrjashtimisht, viti i pare financiar fillon nga data e regjistrimit te shoqërisë ne  
Qendrën Kombëtare te Regjistrimit dhe mbyllet me 31 Dhjetor.

Neni 17

### **Ekspertet**

Eksperti ka për detyre qe te kontrolloje te gjithë dokumentacionin kontabël  
te veprimtarisë ekonomiko tregtare te shoqërisë, atë gjithëvjetor dhe atë ne  
lidhje me kontrollet periodike te ushtruara prej tij për rastet kur ai është  
ngarkuar dhe ka kryer një gjë te tille i ngarkuar nga ana e ortakeve.  
Ne përfundim te kontrollit eksperti kontabël i autorizuar përgatit raportin  
me shkrim për nxjerrjen e rezultatit te bilancit financiar vjetor si dhe për  
atë për kontrollet periodike te ushtruara, te cilat është i detyruar qe  
t'jua paraqesë e dorëzoje ne kohe ortakeve për t'i shqyrtuar e miratuar mbi  
bazën e te drejtës vendimore qe kane.

## **KREU V PRISHJA —RIORGANIZIMI I SHOGERISE**

Neni 18

### **Prishja dhe likuidimi**

Shpërndarja ose prishja a e shoqërisë mund te behet ne çdo kohe :

- a. kur mbaron kohëzgjatja e parashikuar ne themelimin e saj;
- b. me vendim te Asamblesë se Ortakeve;
- c. me hapjen e procedurave te falimentimit;
- d. nëse nuk ka kryer veprimtari tregtare për dy vjet dhe nuk  
është njoftuar pezullimi i veprimtarisë ne përputhje me piken 3 te  
nenit 43 te ligjit nr.9723, date 3.5.2007 "Për Qendrën Kombëtare te  
Regjistrimit";
- e. me vendim te gjykatës;





Ne këtë rast Ortaket marrin vendim me shkrim ne te cilin parashikojnë mënyrën e likuidimit te shoqërisë, duke caktuar 1 apo disa likuidatorë dhe shënuar ne çdo dokument te nxjerre prej tij emrin e likuidatorit dhe emërtesën shtese " Shoqëri ne likuidim e sipër ".

Prishja e shoqërive tregtare ka si pasoje hapjen e procedurave te likuidimit ne gjendjen e aftësisë pagueuse, me përjashtim te rasteve kur është nisur një procedure falimentimi.

Likuidimi kryhet nga likuiduesit e emëruar nga Ortaket.

Nëse Ortaket nuk marrin një vendim për emërimin e likuiduesve, brenda 30 ditëve pas prishjes, çdo person i interesuar mund t'i drejtohet gjykatës, për te caktuar një likuidues.

#### Neni 19

#### **Riorganizimi i shoqërisë bashkimi-ndarja**

Shoqëria mund te ndahet, bashkohet sipas Vendimit te Mbledhjes se Përgjithshme te Asamblesë se Ortakeve, ne përputhje me dispozitat ligjore te parashikuara ne Pjesën IX te Ligjit Nr. 9901 date 14.04.2012 "Për tregtaret dhe shoqëritë tregtare."

#### Neni 20

#### **Baza Ligjore**

Shoqëria do te zhvilloje aktivitetin e saj ne përputhje te plote me këtë statut dhe dispozitat e legjislacionit shqiptar.

Për sa nuk parashikohet ne këtë statut, do te zbatohen dispozitat e ligjit "Për tregtaret dhe shoqëritë tregtare", Kodit Civil dhe çfarëdo ligji tjetër specifik ne Republikën e Shqipërisë.


#### Neni 21

#### **Mosmarrëveshjet**

Për mosmarrëveshjet qe mund te lindin ne lidhje me zbatimin apo interpretimin e këtij statuti, si dhe për çdo mosmarrëveshje qe mund te linde midis Shoqërisë dhe te treteve, do te jete kompetente Gjykata Shqiptare.

**ORTAKET E SHOQERISE ME PERGJEGJESI KUFIZUAR**  
**"PORTONOVA" Sh.P.K:**

1. Agron Hysenaj



2. Artur Shehu përfaqësuar nga Leonard Bishaj

